




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



AKT PËRCJELLËS

Ak	Menaxherin e prokurimit: Komuna Obiliq	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP Nr.125/17
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit 		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën “Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ”, me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121		
Përgjigjeje në ankesë:	N.T “BITI-COM”-Podujevë		
Datë	03.05.2017.		


Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ”**, me nr. prokurimi: **OB/614/17/574/121**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Obiliq**, dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **OE N.T “BITI-COM”**, me seli në Podujevë, me nr.prot.125/17, i datës 21.04.2017

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.


AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

- 1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
- 1x1 Autoriteti Kontraktues.
- 1x1 Operatorit ekonomik ankues.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **“Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ”,** me nr. prokurimi: **OB/614/17/574/121** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Obiliq**.



RAPORTI MBI EKSPEERTIZËN E EKSPEERTIT SHQYRTUES:

	26.04.2017	27.04.2017	03.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit	Data e pranimit të autorizimit	data e fillimit të ekspertizës	data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 21.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 125/17, e parashtruar nga operatori ekonomik N.T “BITI-COM” lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ”, me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Obiliq.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: N.T “BITI-COM”-Podujevë.

Pikat e Ankesës:

Qe nga momenti I publikimit te njoftimit per kontrat e gjere ne permbylljen e ketij aktiviteti te prokurimit gjdo gje ka shkua ne rregull.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

VENDIM: OE. N.T.BITI-COM me seli ne fsh. LUPQ I POSHTEM Komuna Podujeve merr kete vendim qe pas kerkeses per shqyrtim te dosjes se tenderit me nr te prok: OB614-17-574-1-2-1 nga ana e AK. K.K OBILIQ te paraqes kete ankes ne OSHP per aktivitetin e prokurimit ne fjale pasi qe ne si OE I kemi bere nje kerkes per shqyrtim te dosjes se tenderit ne fjale pasi qe AK mendon se ne si OE kemi bere shkelje te ligjit per TVSH.ne pasi qe ne nuk kemi plotesuar pozicionet te norma e TVSH-se . Por arsyeja e mos plotesimit te ketyre pozicioneve nga ana e OE ka qene sepse per produktet e kerkuara nuk paguhet TVSH. Sepse ne si OE realisht jemi ne TVSH dhe ne dosjen e tenderit e kemi futur qertifikaten e TVSH-se. Prandaj ne si kompani mendojme se AK ka bere shkelje te ligjit nr. 04/L-163 per TVSH

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....07.03.2017
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....procedur e hapur/vlerë e mesme
Lloji i kontratës së publikuar(N.16):Furnizim
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):22.03.2017
Data e hapjes së ofertave (N.58):.....22.03.2017-ora 14:00h

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: “Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ”, me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Obiliq.

Njoftimi për dhënien e kontratës.....28.03.2017
 Kriter për dhënien e kontratës.....Çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vërtetje
1	NT BITI-COM	PODUJEVË	-	17,932.66€	JO
2	NNP HYSNIA	VUSHTRRI	-	23,761.50€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit ka marrë pjesë dy (2) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes NUK është rexhistruar vërtetje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Deklarata nën betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneks 2.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Çertifikata e Bisnesit
 Çertifikata e TVSH
 Çertifikata e numrit Fiskal
 Licenca nga MBPZHR.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Një listë origjinale të kontratave të realizuar të natyres së ngjashme në tri vitet e fundit (2014, 2015, 2016).

OE me vendim duhet të emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jetë inxhinjer, apo bachelor, ose teknik i bujqësisë.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Fazli PËRVETICA: Kryesues,
 Linda HYSENI-ADEMI: Anëtar,
 Muharrem KRASNIQI; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 28.03.2017.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **“Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ”,** me nr. prokurimi: **OB/614/17/574/121** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Obiliq.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, konstaton se në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë dy operator ekonomik, OE Biti-com, është i përgjegjshëm për arsye se NUK ka plotësuar çmimin me TVSH.

Komisioni vlerësimit rekomandon për dhënien e kontratës OE Hysnia, me seli në Vushtrri, pasi që i njëjti është i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Përgjigje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:

Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë hapur, vlerë e mesme/ Furnizim, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës të dt.28.03.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatorët ekonomik ankues, NT "Biti-Com", me seli në Podujev, ka parashtruar ankesë në OSHP me datë 21.04.2017, me pretendimet ankimore se Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të ligjit nr.04/L-163, për TVSH.

Pretendimi ankimor nr.1

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues "Biti-Com", sa i përket arsyes të eliminimit në lidhje me normen e TVSH-së,

Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor se i njëjti pretendim ankimor është i bazuar duke u bazuar në atë se Autoriteti kontraktues është i obliguar **korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.**

Citim: interpretimi i KRPP-së të publikuar në pyetje dhe përgjigje nr.46, citojmë: "si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?"

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Eksperti shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit të OE ankues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së, për faktin se në rastin konkret AK-ja është dashur të bëjë kalkulimin e TVSH-së, apo të verifikoj se për të njëjtit produkte a bëjnë pjesë në TVSH, sepse OE ankues

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: "Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ", me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Obiliq.

ka ofruar një listë me të cilën dëshmon se të njëjtit artikuj janë të liruar nga TVSH-ja, njëherit Eksperti shqyrtues i rekomandon AK-së që të verifikoj gjatë ri-vlerësimit se për të njëjtit artikuj a kërkohet TVSH.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të BAZUARA ankesën OE "BITI-COM", me seli në Podujev, dhe njëherit të ANULOJ vendimin "Njoftimi për dhënien e kontratës, i datës 28.03.2017, ndërsa ky aktivitet i prokurimit të kthehet në RI-VLERËSIM, për këtë aktivitet të prokurimit: "Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ", me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Obiliq.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: "Rregullimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara-Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ", me nr. prokurimi: OB/614/17/574/121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Obiliq.

